

010 IDENTIFIKUESI STANDARD NDËRKOMBËTAR I EMRAVE (ISNI)

Fusha përmban treguesin standard ndërkombëtar të emrave (ISNI). Ky numër siguron identifikimin e identiteteve të pjesmarrësve, që i përdorimin publikisht në krijimtarinë e tyre, prodhimin, administrimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve në industrinë mediatike.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
010	Identifikuesi Standard Ndërkombëtar i Emrave (ISNI)	nr
	a <i>Numri</i>	nr
	y <i>ISNI e anuluar</i>	r
	z <i>ISNI e gabuar</i>	r

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

010a Numri

ISNI përbëhet nga 16 numra, pa hapësira mes tyre. Nënfusha a është e detyrueshme, nëse është e pranishme nënfusha z.

010y ISNI e anuluar

Numri i ISNI-së që ka qenë i vlefshëm, mirëpo institucioni për ndarjen e ISNI-së e ka anuluar.

010z ISNI e gabuar

ISNI që është përdorur gabimisht tek identitetet e caktuara ose është i pavlefshëm në ndonjë mënyrë tjetër. Mund t'i jetë ndarë dy identiteteve të ndryshme dhe për këtë arsye është anuluar.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

ISNI ndahet nga institucionet për ndarjen e ISNI-së sipas sistemit të centralizuar dhe në përputhje me ISO 27729. ISNI është numër »memeç«, sepse asnjë pjesë e tij nuk ka ndonjë kuptim të rëndësishëm.

Në standardin ISO 27729 është e përcaktuar:

- pjesmarrësi mund të ketë më shumë se një identitet publik dhe secili nga ata identifikohet me numrin e tij të ISNI-së;
- i njëjti numër i ISNI-së mund të vlej vetëm për një identitet publik të pjesmarrësit;
- drejtshkrimi alternativ, prezantimi alternativ, variantet e simboleve, shkrimet ose variantet e gjuhëve nuk mjaftojnë për ndarjen e numrave të ndryshëm të ISNI-së.

Forma e të dhënave

ISNI përbëhet nga 15 numra, pas të cilëve është numri i kontrollit. Numri i kontrollit mund të jetë nga 0 deri në 9, ose simboli X, i cili llogaritet në bazë të 15 numrave të parë në përputhje me ISO/IEC 7064, sipas algoritmit MOD11-2.

Numri 16 shifror i ISNI-së shënohet në formë të ngjeshur, pa hapësira apo shenja pikësimi. Para numrave nuk vendoset shenja e ISNI-së.

Për përdoruesit ISNI shfaqet si një numër 16 shifror, i ndarë në katër pjesë me nga katër numra, pjesët të ndara mes mes vete me hapësirë. Para tyre ndodhet shkurtësia ISNI dhe hapësira.

ISNI është i përdorshëm dhe i zberthyeshem si <http://www.isni.org/XXXXXXXXXXXXXXXXXX>

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 200** *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR VETJAK*
210 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR ORGANIZATE*
220 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR FAMILJE*
400 *VARIANTI I PIKËQASJES – EMËR VETJAK*
410 *VARIANTI I PIKËQASJES – EMËR ORGANIZATE*
420 *VARIANTI I PIKËQASJES – EMËR FAMILJE*

SHEMBUJ

1.

010	□□	a0000000121035067
200	□1	aLévi-Strauss bClaude f1908-2009
300	0□	aPhilosophe et anthropologue
300	0□	aMembre de l'Académie française (élu en 1974)
400	□1	aStrauss bClaude Lévi- f1908-2009
400	□1	aLévy-Strauss bClaude f1908-2009
400	□1	aStrauss bClaude Lévy- f1908-2009

(Regjistrimi përmban vetëm një identitet. Në fushat 400 janë vendosur format alternative të emrit, të cilat nuk i plotësojnë kushtet për ndarjen e numrit ISNI.)

2.

010	□□	a 0000000120300340
200	□1	a Vargas b Fred f 1957-....
300	0□	a Archéologue
300	0□	a Auteur de romans policiers
500	□1	3 120572294 a Audoin-Rouzeau b Frédérique f 1957-....

010	□□	a 000000036862981X
200	□1	a Audoin-Rouzeau b Frédérique f 1957-....
300	0□	a Archéozoologue
300	0□	a Membre de l'ERA 38 du Centre de recherches archéologiques du CNRS de Sophia-Antipolis, Alpes de Haute-Provence et de l'URA 1415 (en 1991)
300	0□	a Connue également comme auteur de romans policiers sous le pseudonyme "Vargas, Fred (1957-....)"
400	□1	a Rouzeau b Frédérique f 1957-....
400	□1	a Audouin-Rouzeau b Frédérique f 1957-....
400	□1	a Rouzeau b Frédérique f 1957-....
500	□1	3 120583593 a Vargas b Fred f 1957-....

(Secili regjistrim përmban identitet tjetër për personin e njëjtë. Çdo regjistrim ka një fushë 010 për numrin ISNI, i cili është i lidhur me identitetin që e prezanton regjistrimi. Të dy regjistrimet janë të lidhur mes vete përmes fushës 500.)

3.

010	□□	a 0000000121068125
210	02	a London school of economics and political science
410	02	a LSE
410	02	a London school of economics
410	02	a University of London b London school of economics and political science

(Në fushën 010 është shënuar numri ISNI i organizatës.)